NJOFTIM MBI LISTËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK PËR NGRITJE NË DETYRË/PRANIM NË KATEGORINË E ULËT DREJTUESE

Njësia Përgjegjëse pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në zbatim të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, Kreut V "Lëvizja paralele dhe Ngritja në detyrë", nenit 26, si dhe të pikës 24 të Kreut III të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 242, datë 18.03.2015 "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", i ndryshuar, në përfundim të afatit për pranimin e dokumenteve, si dhe verifikimit paraprak të kandidatëve për përmbushjen e kushteve dhe kritereve të veçanta për ngritjen në detyrë dhe/ose pranim nga jashtë shërbimit civil, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim, deri më 17.11.2026, njofton se për pozicionin:

1- **"Inspektor IT" 1 (një) në Drejtorinë e Lobimit, në Drejtorinë e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit, pranë KDIMDP-së**

   Kategoria e pagës III-1

Kandidatët e kualifikuar për të vazhduar fazën e dytë të konkurrimit janë:

- Marlin Mitku
- Endri Halili

A. Testimi me shkrim do të zhvillohet në datën 04.12.2026, ora 11:00, në ambientet e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, adresa Rr. "Abdi Toptani", Nd. 5, Tiranë.
B. Intervista e strukturuar me gojë do të zhvillohet pas testimit me shkrim.

Vëmendje: Në rast të ndryshimit të datës së testimit me shkrim/intervistës me gojë do të njoftoheni nëpërmjet faqes zyrtare, por edhe elektronikisht në *email*-in personal, të konfirmuar në dokumentacionin e dorëzuar.

Njësia Përgjegjëse